



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 507, datë 25.10.2021

PËR
RICAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT Z. {...},
NË GJYKATËN E APELIT DURRËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “ë” dhe nenin 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 45, pika 4, shkronja “a” dhe pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Durrës, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën deri më datë 05.11.2022.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 05.11.2021.
3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Durrës.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR